




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 40 /2021

Nr. Protokolli: 55/2021

Për:	" K.S.AS - SECURITY" SH.P.K., Rr. Magjistratja Prishtinë -Mitrovicë p.n., 10000, PRISHTINË&K.S. Besa Security SH.P.K., Rr. Jusuf Gërvalla nr.64, 10000, Prishtinë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	30.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 28.04.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: " K.S.AS - SECURITY" SH.P.K., Rr. Magjistratja Prishtinë -Mitrovicë p.n., 10000, PRISHTINË&K.S., Besa Security SH.P.K., Rr. Jusuf Gërvalla nr.64, 10000, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të sigurimit fizik të objekteve Komunale dhe shkollave të mesme" me Nr. të Prokurimi: 624-21-647-2-2-1& 624-021-045-221 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 28.04.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: " K.S.AS - SECURITY" SH.P.K., Rr. Magjistratja Prishtinë -Mitrovicë p.n., 10000, PRISHTINË&K.S., Besa Security SH.P.K., Rr. Jusuf Gërvalla nr.64, 10000, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të sigurimit fizik të objekteve Komunale dhe shkollave të mesme", kundër Njoftimit për Vendimin e AK –së, të datës 23. 04.2021 të publikuar në platformen elektronike.
- II. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 23.04.2021.
- III. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **23.04.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit “**Shërbime të sigurimit fizik të objekteve Komunale dhe shkollave të mesme**” me Nr. të Prokurimi: **624-21-647-2-2-1& 624-021-045-221**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës **23.04.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se me me dosje te tenderit, dhe se krahasimi i ofertave të bëra nga komisioni për vlerësim dhe krahasim është bazuar se çmime të dhëna nga OE dhe se pretendimet tuaja nuk korospondon me kalkulimin e bërë ne paramase, sipas pershkrimeve dhe arsyeve te cilat kenë paraqit ne kerkesen per ri-shqyrtim.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI

